



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS TRANSPORTIT DHE
MJEDISIT

Nr. 11677 Prot

Lezhë më 17.6.2026

PROJEKT-VENDIM

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E SHËRBIMIT FUNERAL NË BASHKINË LEZHË”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e shërbimit funeral në Bashkinë Lezhë bashkëlidhur projekt-vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE
MJEDISIT

Nr. 11677/1 Prot,

Lezhë, me 17.6.2026

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E SHËRBIMIT FUNERAL NË BASHKINË LEZHË”

Ky projekt-vendim paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Lezhë në mbështetje të

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 711, datë 29.10.2014;

Qëllimi i kësaj rregullore është rregullimi e plotë dhe të unifikuar të administrimit dhe funksionimit të shërbimit funeral në territorin e Bashkisë Lezhë. Nevoja për këtë akt lind nga domosdoshmëria për të përmirësuar standardet e shërbimit dhe për të qartësuar përgjegjësitë institucionale

Projekt-vendimi synon krijimin e një kuadri të qartë rregullator për organizimin dhe ofrimin e shërbimit funeral, duke përcaktuar rregulla të detajuara për administrimin e varrezave publike, procedurat e varrimit dhe zhvarrimit, si dhe për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës funerare. Një vëmendje e veçantë i kushtohet garantimit të standardeve higjieno-sanitare, mbrojtjes së shëndetit publik dhe respektimit të normave ligjore, kulturore dhe fetare. Nëpërmjet këtij akti përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë Lezhë, duke përfshirë Drejtorinë e Shërbimeve Publike, njësitë administrative dhe Policinë Bashkiake, me qëllim sigurimin e një funksionimi të koordinuar dhe efikas të shërbimit në të gjithë territorin..

Po ashtu, vendosen rregulla të qarta për administrimin e hapësirave funerale, mbajtjen e regjistrave, digjitalizimin e të dhënave, si dhe për vendosjen e monumenteve funerare, duke synuar transparencë, dhe përdorim racional të hapësirave publike. Një element i rëndësishëm është edhe përcaktimi i tarifave të shërbimit funeral, si dhe mundësia për aplikimin e lehtësirave për kategoritë në nevojë, në funksion të politikave sociale të Bashkisë. Në projekt parashikohen gjithashtu mekanizma të qartë kontrolli dhe inspektimi, si dhe masa administrative për rastet e shkeljeve, duke synuar forcimin e zbatimit të rregullave dhe ruajtjen e standardeve të shërbimit.

Si përfundim, miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm për të garantuar një shërbim funeral të organizuar, të standardizuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe sociale, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve dhe duke forcuar rolin e Bashkisë Lezhë në administrimin e këtij shërbimi publik me rëndësi të veçantë.

KRYETARI
Pjerin NDREU





BASHKIA LEZHË

RREGULLORE

“PËR ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT FUNERAL NË BASHKINË LEZHË”

Neni 1

Objekti

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për administrimin dhe funksionimin e shërbimit funeral në territorin e Bashkisë Lezhë, duke synuar një organizim të qartë, të unifikuar dhe efikas të këtij shërbimi publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet përkatëse.
2. Në mënyrë të veçantë, ky vendim synon:
 - a) përcaktimin e mënyrës së organizimit, funksionimit dhe ofrimit të shërbimit funeral, duke garantuar respektimin e dispozitave ligjore dhe standardeve teknike e higjieno-sanitare;
 - b) saktësimin e ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe njësive administrative, lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e varrezave publike;
 - c) garantimin e një trajtimi dinjitoz, të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë qytetarët, duke respektuar normat ligjore, sociale, kulturore dhe fetare që lidhen me shërbimin funeral.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky vendim zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë dhe përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me shërbimin funeral. Konkretisht:

- a) administrimin dhe menaxhimin e varrezave publike, përfshirë organizimin e hapësirave dhe përdorimin e tyre;
- b) realizimin e shërbimit të varrimit dhe procedurave të zhvarrimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe sanitare;
- c) mirëmbajtjen, sistemimin, gjelbërimin dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore në varreza;
- d) mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për çdo varrim, duke garantuar saktësinë dhe transparencën e të dhënave;
- e) ofrimin e shërbimeve ndihmëse funerale dhe mbikëqyrjen e tyre nga autoritetet vendore;
- f) vendosjen dhe kontrollin e monumenteve funerare në përputhje me rregullat e miratuara.

Neni 3

Parimet bazë

Shërbimi funeral ushtrohet mbi bazën e parimeve të mëposhtme:

- a) respektimit të dinjitetit njerëzor dhe kujtimit të të ndjerit në çdo fazë të procesit;
- b) garantimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në trajtimin e qytetarëve;
- c) zbatimit të ligjshmërisë dhe transparencës në çdo veprim administrativ;
- d) respektimit të kushteve higjieno-sanitare dhe mbrojtjes së shëndetit publik;
- e) sigurimit të cilësisë, vazhdimësisë dhe efikasitetit të shërbimit;
- f) përdorimit racional dhe të kontrolluar të hapësirave funerale në funksion të interesit publik.

Neni 4

Administrimi i varrezave publike

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për administrimin e varrezave kryesore të Bashkisë Lezhë, duke përfshirë organizimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre në përputhje me standardet ligjore dhe teknike;
2. Kjo përgjegjësi përfshin konkretisht varrezat në Grykë Zezë, varrezat e reja në Mërqi, varrezat në Gocaj, varrezat në Kodër Marlekaj dhe varrezat e Dëshmorëve, ku sigurohet funksionimi i rregullt dhe kontrolli i vazhdueshëm;
3. Njësitë administrative administrojnë varrezat që ndodhen në territorin e tyre, duke u kujdesur për mirëmbajtjen, organizimin dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë vendim;
4. Të gjitha strukturat përgjegjëse janë të detyruara të bashkëpunojnë për të garantuar një standard të unifikuar në të gjithë territorin e bashkisë.

Neni 5

Organizimi i shërbimit funeral

1. Shërbimi funeral në territorin e Bashkisë Lezhë organizohet, drejtohet dhe mbikëqyret nga strukturat përkatëse të Bashkisë, të cilat janë përgjegjëse për garantimin e funksionimit të tij në mënyrë të rregullt, të koordinuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Organizimi i shërbimit funeral përfshin tërësinë e veprimeve administrative dhe operative që lidhen me procesin e varrimit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë:
 - a) përcaktimin dhe dhënien në përdorim të vendit të varrimit, në përputhje me planifikimin dhe organizimin e varrezave publike;
 - b) organizimin dhe realizimin e ceremonisë së varrimit, duke garantuar respektimin e rregullave, rendit publik dhe dinjitetit të ceremonisë;
 - c) mbikëqyrjen e procesit të varrimit dhe koordinimin me strukturat përkatëse dhe subjektet e autorizuar;
 - d) sigurimin dhe kontrollin e kushteve të përshtatshme teknike dhe higjieno-sanitare gjatë gjithë procesit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik;
3. Shërbimi funeral realizohet në bashkëpunim të ngushtë me familjarët e të ndjerit dhe subjektet e licencuara, duke garantuar ofrimin e një shërbimi korrekt, të përgjegjshëm dhe në kohë.
4. Gjatë organizimit dhe zhvillimit të ceremonive funerale respektohen traditat, zakonet dhe praktikat fetare apo kulturore të komunitetit, për aq sa ato nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe rendin publik.

Neni 6

Procedura e varrimit

1. Procedura e varrimit fillon me paraqitjen pranë strukturave përkatëse të Bashkisë të dokumentacionit të nevojshëm nga familjarët e të ndjerit ose përfaqësuesit e tyre ligjorë, ku përfshihet certifikata e vdekjes dhe kërkesa për kryerjen e varrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Pas paraqitjes së dokumentacionit, strukturat përgjegjëse të Bashkisë kryejnë verifikimin e tij dhe procedojnë me caktimin e vendit të varrit, duke respektuar planifikimin urban të varrezave, rregullat e organizimit të hapësirave dhe disponueshmërinë e tyre.
3. Procesi i varrimit realizohet brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe në përputhje me standardet teknike dhe higjieno-sanitare, duke garantuar sigurinë publike dhe mbrojtjen e shëndetit të komunitetit.
4. Gjatë zhvillimit të ceremonisë së varrimit, strukturat përgjegjëse marrin masa për garantimin e rendit publik, respektimin e dinjitetit të të ndjerit dhe zhvillimin e rregullt të ceremonisë, në përputhje me normat shoqërore dhe ligjore.
5. I gjithë procesi i varrimit dokumentohet dhe regjistrohet në regjistrat përkatës të Bashkisë, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe administrimin korrekt të të dhënave.

Neni 7

Procedura e zhvarrimit

1. Zhvarrimi lejohet dhe kryhet vetëm në raste të veçanta të justifikuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar rregullat për mbrojtjen e shëndetit publik dhe rendit.
2. Zhvarrimi realizohet mbi bazën e një vendimi të organeve kompetente ose me kërkesë të motivuar të familjarëve të të ndjerit, e cila shqyrtohet dhe miratohet nga Bashkia Lezhë në përputhje me procedurat administrative në fuqi.
3. Procesi i zhvarrimit zhvillohet nën mbikëqyrjen e strukturave përgjegjëse dhe në kushte të rrepta higjieno-sanitare, duke garantuar sigurinë e personelit dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.
4. Gjatë kryerjes së zhvarrimit respektohen standardet teknike, procedurat ligjore dhe dinjiteti i të ndjerit, si dhe merren masat e nevojshme për zhvillimin e rregullt dhe të kontrolluar të procesit.
5. Çdo veprim i kryer në kuadër të zhvarrimit dokumentohet dhe regjistrohet në mënyrë të plotë në regjistrat përkatës, duke garantuar transparencën dhe gjurmueshmërinë administrative.

Neni 8

Regjistri i varrezave

1. Bashkia Lezhë mban dhe administron regjistrin e varrezave publike, si në formë fizike ashtu edhe elektronike, duke siguruar evidentimin e plotë dhe të saktë të të gjitha rasteve të varrimit dhe zhvarrimit në territorin e saj administrativ.
2. Regjistri i varrezave përmban të dhëna të detajuara dhe të strukturuar për çdo person të varrosur, ku përfshihen në mënyrë të veçantë:

- a) të dhënat identifikuese të personit të ndjerë, sipas dokumentacionit zyrtar;
- b) vendndodhja e saktë e varrit, në përputhje me planimetrinë dhe organizimin e varrezave;
- c) data e varrimit dhe, kur është rasti, të dhëna mbi zhvarrimin ose transferimin e eshtrave;
3. Njësitë administrative janë përgjegjëse për mbajtjen, përditësimin dhe administrimin e regjistrave përkatës për varrezat në juridiksionin e tyre, duke garantuar saktësinë, plotësinë dhe përditësimin në kohë të të dhënave.
4. Të dhënat e regjistrit ruhen, përpunohen dhe administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informacionit, duke garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e tyre.
5. Bashkia merr masa për digjitalizimin dhe integrimin e të dhënave të regjistrit, me qëllim përmirësimin e aksesit, administrimit dhe kontrollit të informacionit në funksion të shërbimit publik.

Neni 9

Mirëmbajtja e varrezave

1. Mirëmbajtja e varrezave publike në territorin e Bashkisë Lezhë përbën një detyrim të vazhdueshëm institucional dhe përfshin tërësinë e veprimeve që synojnë ruajtjen e tyre në gjendje të rregullt, funksionale dhe dinjitoze, në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe mjedisore në fuqi.
2. Në kuadër të mirëmbajtjes së varrezave publike, strukturat përgjegjëse kryejnë në mënyrë të rregullt dhe të organizuar:
 - a) pastrimin periodik të hapësirave të varrezave, duke përfshirë largimin e mbetjeve dhe mirëmbajtjen e rendit dhe pastërtisë;
 - b) gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e elementeve të peizazhit, me qëllim përmirësimin e kushteve estetike dhe mjedisore;
 - c) sistemin dhe mirëmbajtjen e rrugicave të brendshme, si dhe sigurimin e aksesueshmërisë për qytetarët;
 - d) sigurimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik në ambientet e varrezave, në funksion të sigurisë dhe përdorimit të tyre;
 - e) menaxhimin e mbetjeve të krijuara në varreza, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik;
3. Strukturat përgjegjëse marrin masa për garantimin e sigurisë dhe ruajtjes së varrezave, duke parandaluar dëmtimet, ndërhyrjet e paligjshme apo përdorimin e papërshtatshëm të hapësirave funerale.
4. Bashkia, nëpërmjet strukturave të saj, siguron kontrollin periodik të gjendjes së varrezave dhe ndërmerr masa për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve dhe standardeve të mirëmbajtjes.

Neni 10

Ndërtimet dhe monumentet funerare

1. Vendosja e monumenteve funerare, si dhe çdo ndërhyrje ndërtimore brenda territorit të varrezave publike, lejohet vetëm pas pajisjes me leje nga Bashkia Lezhë, në përputhje me rregullat, standardet dhe kriteret e përcaktuara për këtë qëllim.
2. Në kuadër të rregullimit dhe administrimit të hapësirave funerale, ndalohet në mënyrë të shprehur:
 - a) kryerja e çdo lloj ndërtimi apo vendosja e monumenteve funerare pa autorizimin përkatës nga Bashkia;
 - b) zënia, shfrytëzimi apo cenimi i hapësirave të përbashkëta, si dhe tejkalimi i kufijve të përcaktuar për sipërfaqen e varrit;
3. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi zbatimin e rregullave dhe standardeve për ndërtimet dhe monumentet funerare, duke verifikuar respektimin e kufijve, përmasave dhe kriterëve teknike të miratuara në Vendimin nr.712 datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”
4. Në rast konstatimi të shkeljeve, Bashkia ndërhyr për pezullimin e menjëhershëm të punimeve, heqjen e ndërtimeve të paligjshme dhe rikthimin e hapësirës në gjendjen e mëparshme, duke zbatuar masat administrative përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
5. Çdo ndërhyrje në varreza duhet të respektojë karakterin publik të tyre, ruajtjen e rendit, sigurisë dhe dinjitetit të ambientit funeral, si dhe të mos pengojë aksesin dhe përdorimin normal nga qytetarët.

Neni 11

Tarifat e shërbimit funeral

1. Shërbimi funeral në territorin e Bashkisë Lezhë ofrohet kundrejt pagesës, sipas tarifave të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak, të cilat përcaktohen në mënyrë të qartë, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Tarifat e shërbimit funeral përfshijnë në mënyrë të veçantë:
 - a) shërbimin e varrimit;
 - b) mirëmbajtjen e varrezave publike, si pjesë e detyrimeve për garantimin e kushteve të përshtatshme mjedisore dhe funksionale;
 - c) rezervimin dhe përdorimin e vendit të varrimit, sipas planifikimit dhe organizimit të hapësirave funerale;
3. Për kategori të caktuara sociale, në nevojë ekonomike ose në kushte të veçanta, Bashkia Lezhë mund të aplikojë përjashtime të pjesshme ose të plota nga pagesa, si dhe lehtësira financiare, në përputhje me politikat sociale dhe fondet e miratuara në buxhetin vjetor.

4. Pagesat për shërbimet funerale kryhen sipas procedurave të përcaktuara nga Bashkia dhe dokumentohen në mënyrë të rregullt, duke garantuar transparencën dhe kontrollin financiar të tyre

Neni 12

Bashkëpunimi institucional

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe njësitë administrative të Bashkisë Lezhë bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme, të koordinuar dhe të detyrueshme për garantimin e funksionimit efikas, të rregullt dhe të unifikuar të shërbimit funeral në të gjithë territorin administrativ të bashkisë.
 2. Ky bashkëpunim institucional synon në veçanti:
 - a) unifikimin e procedurave administrative dhe teknike për ofrimin e shërbimit funeral, me qëllim sigurimin e standardeve të njëjta në çdo njësi administrative;
 - b) shkëmbimin e informacionit në kohë reale ndërmjet strukturave përgjegjëse, për administrimin e varrezave, regjistrave dhe rasteve të varrimit apo zhvarrimit;
 - c) koordinimin e veprimeve operative dhe administrative për garantimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit;
 3. Bashkëpunimi institucional shtrihet gjithashtu në menaxhimin e situatave të veçanta, emergjencave apo rasteve të jashtëzakonshme, ku kërkohet ndërhyrje e menjëhershme dhe e koordinuar ndërmjet strukturave të Bashkisë.
 4. Strukturat përkatëse janë të detyruara të marrin masa organizative dhe teknike për të siguruar komunikim të vazhdueshëm dhe efektiv, si dhe zbatimin e vendimeve të përbashkëta në funksion të interesit publik.
-
1. Ushtrimi i veprimtarisë nga subjektet private është objekt kontrolli dhe mbikëqyrjeje të vazhdueshme nga strukturat përkatëse të Bashkisë, të cilat verifikojnë respektimin e kushteve të licencimit dhe standardeve të shërbimit.
 2. Në rast konstatimi të shkeljeve të dispozitave ligjore ose të këtij vendimi, Bashkia merr masat përkatëse administrative, përfshirë paralajmërimin, pezullimin e aktivitetit ose heqjen e të drejtës për ushtrimin e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Kontrolli dhe inspektimi

1. Kontrolli dhe inspektimi mbi zbatimin e këtij vendimi ushtrohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Lezhë, të cilat veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre ligjore dhe administrative, si dhe me aktet nënligjore në fuqi.
2. Në kuadër të ushtrimit të kontrollit, strukturat përkatëse verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike:
 - a) zbatimin e saktë dhe të plotë të dispozitave të kësaj rregulloreje nga subjektet publike dhe private;
 - b) respektimin e kushteve higjieno-sanitare, sigurisë publike dhe standardeve mjedisore në ambientet e varrezave;
3. Në rast konstatimi të shkeljeve të dispozitave të këtij vendimi, strukturat përgjegjëse propozojnë dhe marrin masat administrative përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë paralajmërime, gjoba, pezullim aktiviteti ose masa të tjera të parashikuara me ligj.
4. Bashkia siguron që kontrolli dhe inspektimi të ushtrohet në mënyrë të rregullt, të paanshme dhe të koordinuar, me qëllim garantimin e standardeve të shërbimit funeral në të gjithë territorin.

Neni 14

Kundërvajtjet dhe sanksionet

1. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe sjell përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes, ndaj subjekteve apo personave përgjegjës zbatohen masat administrative të mëposhtme:
 - a) vendosja e gjobave administrative, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe aktet nënligjore në fuqi;
 - b) heqja, pezullimi ose revokimi i lejeve apo autorizimeve të dhëna nga Bashkia për kryerjen e aktiviteteve përkatëse në varreza;
 - c) detyrimi për rikthimin e menjëhershëm të gjendjes në gjendjen e mëparshme, përfshirë heqjen e ndërtimeve të paligjshme ose riparimin e dëmtimeve të shkaktuara;
3. Zbatimi i masave ndëshkuese nuk përjashton përgjegjësinë tjetër administrative, civile apo penale që mund të rrjedhë nga shkelja e dispozitave ligjore në fuqi.

4. Strukturat kompetente të Bashkisë janë të ngarkuara për evidentimin, dokumentimin dhe ndjekjen e procedurave përkatëse për konstatimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve.

Neni 15

Ngarkohen për zbatim

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit

Kjo drejtori është struktura kryesore përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e shërbimit funeral dhe ka këto detyra:

- a) organizimin e përgjithshëm të shërbimit funeral dhe garantimin e funksionimit të tij sipas këtij vendimi;
- b) administrimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e varrezave publike në juridiksionin e Bashkisë;
- c) mbajtjen dhe administrimin e regjistrave zyrtarë të varrezave, përfshirë përditësimin e të dhënave;
- d) koordinimin me njësitë administrative për zbatimin e unifikuar të procedurave;
- e) mbikëqyrjen e subjekteve të kontraktuara dhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve;
- f) propozimin e masave për përmirësimin e infrastrukturës funerare dhe kushteve të varrezave.

2. Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë

Njësitë administrative janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi në territorin e tyre dhe kanë këto detyra:

- a) administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike që ndodhen në juridiksionin e tyre;
- b) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrave lokalë të varrimeve dhe të dhënave përkatëse;
- c) zbatimin e procedurave të varrimit dhe zhvarrimit sipas rregullave të përcaktuara;
- d) bashkëpunimin me Drejtorinë e Shërbimeve Publike për unifikimin e standardeve të shërbimit;
- e) informimin e qytetarëve dhe koordinimin me familjarët gjatë procedurave funerale.

3. Policia Bashkiake

Policia Bashkiake ngarkohet për garantimin e rendit dhe zbatimin e rregullave në territorin e varrezave dhe ka këto detyra:

- a) mbikëqyrjen e rendit publik gjatë zhvillimit të ceremonive funerale;
- b) parandalimin dhe ndalimin e çdo veprimtarie të paligjshme në territorin e varrezave;
- c) kontrollin e respektimit të hapësirave dhe kufijve të varreve;

- d) bashkëpunimin me strukturat e Bashkisë për zbatimin e vendimeve administrative;
- e) ndërhyrjen në rast shkeljesh dhe referimin e tyre pranë organeve kompetente.

Neni 16

Dispozita kalimtare

1. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Lezhë detyrohen të marrin të gjitha masat e nevojshme organizative, administrative dhe teknike për zbatimin e këtij vendimi, brenda një afati maksimal prej 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij, duke siguruar funksionimin e plotë dhe të rregullt të shërbimit funeral sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
2. Gjatë periudhës kalimtare, strukturat përgjegjëse sigurojnë koordinimin ndërinstitutional dhe marrin masa për shmangien e ndërprerjeve në ofrimin e shërbimit funeral, duke garantuar vazhdimësi dhe funksionim normal të tij.
3. Çdo praktikë administrative ekzistuese që bie ndesh me këtë vendim rishikohet dhe përshtatet në përputhje me dispozitat e reja, brenda afateve të përcaktuara nga Bashkia.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas shpalljes sipas legjislacionit në fuqi.

KRYETARI

Pjerin NDREU

